



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 05.06.2019

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË ARABISË SAUDITE, PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT DHE KAPITALIN”

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 05.06.2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten znj. Aurora Mara.

Në mbledhjen e komisionit, për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të komisionit, ishte i pranishëm z. Elton Haxhi, zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

II. QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i propozuar ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Arabisë Saudite, për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat dhe kapitalin”.

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje luan një rol të rëndësishëm në kompleksin e faktorëve që garantojnë, favorizojnë dhe stimulojnë marrëdhëniet ekonomiko - tregtare, ku shtetet shkëmbejnë informacione dhe bashkëpunojnë për parandalimin e evazionit fiskal nga subjektet që kanë aktivitete në të dy vendet. Rëndësia e këtyre marrëveshjeve po rritet vazhdimisht në kushtet e rritjes së aktiviteteve të biznesit të shoqërive shumëkombëshe dhe në kushtet e rritjes së vazhdueshme të lëvizjes së lirë ndërkombëtare të njerëzve, kapitaleve, mallrave dhe parave.

Duke patur aktivitete në të dy shtetet apo duke qenë rezident i njërit shtet që siguron të ardhura në shtetin tjetër, individit apo personi juridik mund të rëndohet me tatim të dyfishtë (për të njëjtën të ardhur të tatohet dy herë), gjë që mund të krijojë premisa për shmangie të tatimit dhe evazion fiskal. Kjo marrëveshje, trajton pikërisht faktin se si do të shmanget tatimi i dyfishtë, duke i dhënë të drejtën për tatimin e të ardhurave të caktuara vetëm njërit shtet apo duke e ndarë këtë të drejtë midis të dy shteteve, por pa e rënduar subjektin me tatim të dyfishtë.

Marrëveshja përbëhet nga 30 nene, të cilat përcaktojnë: tatimet për të cilat zbatohet marrëveshja; kriteret e përcaktimit të banimit për efekt fiskal; konceptin e “selisë së përhershme” të biznesit; të drejtën e plotë tatimore të tatimit mbi të ardhurat nga pasuritë e paluajtshme; trajtimin e të ardhurave nga transporti ndërkombëtar; të drejtën tatimore për të ardhurat nga shërbimet personale të pavarura dhe të varura, të ardhurat e artistëve dhe sportistëve, të ardhurat nga pensionet; tarifat e drejtuesve të kompanive; të drejtën për tatimin e kapitalit etj. Marrëveshja gjithashtu, parashikon dispozita në bazë të të cilave shtetet kontraktuese shkëmbejnë informacione dhe bashkëpunojnë për parandalimin e evazionit fiskal për subjektet që kanë aktivitete në të dy vendet.

Kjo marrëveshje është miratuar me vendimin nr. 350 datë 23.05.2012 të Këshillit të Ministrave, është nënshkruar nga palët më datë 6 shkurt 2019 në Riad të Arabisë Saudite dhe parashikohet të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas muajit në të cilin është marrë njoftimi i fundit lidhur me plotësimin e procedurave ligjore të qeverive të shteteve kontraktuese.

Marrëveshja do të jetë në fuqi për një periudhë kohe të pakufizuar, por secila nga palët, pas një periudhe prej 5 vitesh nga hyrja në fuqi, mund të njoftojë palën tjetër nëpërmjet rrugëve diplomatike për përfundimin e saj.

III. PËRFUNDIM

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm dhe u shpreh dakord për kalimin për votim në seancë plenare.

RELATORE

KRYETAR

AURORA MARA

ULSI MANJA